<p>komunikimeve elektronike.</p> <p>7. Në rastet kur të drejtat individuale për shfrytëzim të radio-frekuencave janë dhënë për 10 apo më shumë vite dhe të drejtat e tilla nuk mund të transferohen apo të jepen me qira në mes të ndërmarrësve, Autoriteti duhet të sigurojë që kriteret për dhënie të të drejtës individuale për shfrytëzim aplikohen dhe janë konform përgjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së licencës, e posaçërisht në rastet kur shfrytëzuesi i të drejtës për shfrytëzim e bën një kërkesë të tillë dhe të njëjtën e arsyeton. Nëse këto kriteret nuk janë më të aplikueshme, e drejta individuale për shfrytëzim të radio frekuencave duhet të ndryshohet në autorizim të përgjithshëm për shfrytëzim të radio frekuencave, pas njoftimit paraprak dhe pas një periudhe të caktuar kohore, ose këto të drejta duhet të bëhen të transferueshme ose të jepet mundësia e dhënies me qira në mes të ndërmarrësve.</p> <p>8. Autoriteti duhet të sigurojë që radio frekuencat shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive në pajtim me këtë Ligj. Ata duhet të sigurojnë që konkurrenca të mos shtrembërohet si</p>	<p>7. Where individual rights to use radio frequencies are granted for 10 years or more and such rights may not be transferred or leased between undertakings the Authority shall ensure that the criteria to grant individual rights of use apply and are complied with for the duration of the license, in particular upon a justified request of the holder of the right. If those criteria are no longer applicable, the individual right of use shall be changed into a general authorization for the use of radio frequencies, subject to prior notice and after a reasonable period, or shall be made transferable or leasable between undertakings.</p> <p>8. Authority shall ensure that radiofrequencies are efficiently and effectively used in accordance with this Law. They shall ensure competition is not distorted by any transfer or</p>	<p>7. U slučajevima kada je individualno pravo na korišćenje radio-frekvencija dodeljeno na 10 ili više godina, a ta prava se ne mogu preneti ili dati u zakup između preduzetnika, Autoritet mora da obezbedi da se kriterijumi za dodelu individualnih prava primenjuju i koriste tokom celog perioda važenja licence, posebno u slučajevima kada korisnik prava na korišćenje podnese takav zahtev i isti obrazloži. Ako ti kriterijumi nisu više primenljivi, individualno pravo na korišćenje radio-frekvencija treba da bude izmenjeno u opštem odobrenju za korišćenje radio-frekvencija, nakon prethodnog obaveštavanja i posle određenog vremenskog perioda, ili ta prava treba da postanu prenosiva ili da se da mogućnost davanja u zakup između preduzetnika.</p> <p>8. Autoritet mora da osigura da se radio-frekvencije koriste efikasno i efektivno u skladu sa ovim zakonom. Oni treba da obezbede da konkurencija ne bude nelojalna kao rezultat bilo kakvog</p>
--	--	---



<p>pasojë e çfarëdo transferi apo akumulimi të së drejtës për shfrytëzim të radio-frekuencave. Për këto qëllime, Autoriteti mund të ndërmarrë masa të përshtatshme si detyrimi i shitjes apo dhënies me qira të së drejtës për të shfrytëzuar radio-frekuencat.</p> <p style="text-align: center;">Neni 55 Ndryshimi i kushteve për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike</p> <p>Të drejtat, kushtet dhe procedurat që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike mund të ndryshohen vetëm në rastet objektivist të arsyeshme dhe në mënyrë proporcionale duke marrë parasysh kushtet që kanë të bëjnë me transferin ose qiradhënien e të drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave. Njoftimi i duhur dhe paraprak duhet të jepet për qëllim të ndryshimeve dhe palëve me interes përfshirë shfrytëzuesëve dhe konsumatorëve duhet t'u jepet kohë e mjaftueshme për të shprehur pikëpamjet e veta, por jo më pak se 30 ditë përveç në rastet e jashtëzakonshme. Kur ndryshimet për kushtet për shfrytëzimin e</p>	<p>accumulation of rights of use of radio frequencies. For such purposes, Authority may take appropriate measures such as mandating the sale or the lease of rights to use radio frequencies.</p> <p style="text-align: center;">Article 55 Change of Conditions for Usage of Electronic Communications Resources</p> <p>The rights, conditions and procedures relating to the use of electronic communications resources may only be amended in objectively justified cases and in a proportionate manner taking into account conditions related to the transfer or lease of the right of use the radio frequencies. Notice shall be given in an appropriate manner of the intention to make such amendments and interested parties, including users and consumers, shall be allowed a sufficient period of time to express their views on the proposed amendments, which shall be no less than 30 days except in exceptional circumstances. Where amendments of the conditions for usage of radio frequencies</p>	<p>prenosa ili dobijanja prava na korišćenje radio-frekvencija. Za te svrhe, Autoritet može da preuzme odgovarajuće mere, kao što je obavezivanje na prodaju ili davanje u zakup prava na korišćenje radio-frekvencija.</p> <p style="text-align: center;">Član 55 Izmena uslova za korišćenje resursa elektronskih komunikacija</p> <p>Prava, uslovi i postupci koji se odnose na korišćenje resursa elektronskih komunikacija mogu biti izmenjeni samo u objektivno opravdanim slučajevima i na proporcionalan način imajući u vidu uslove koji se odnose na prenos ili zakup prava na korišćenje radio-frekvencija. Odgovarajuće prethodno obaveštenje o svrsi izmena mora biti dostavljeno i zainteresovanim stranama, uključujući i korisnike i potrošače i treba im dati dovoljno vremena da iznesu svoje stavove, ali ne manje od 30 dana, osim u izuzetnim slučajevima. Kada su izmene uslova za korišćenje radio-frekvencija (kanala) zasnovane na kriterijumima utvrđenim u zakonskim aktima koji se</p>
--	---	--



<p>radio-frekuencave (kanaleve) bazuar në kriteret e vendosura në aktet juridike kanë të bëjnë me mbulueshmërinë e territorit me sinjal radio dhe TV difuziv, apo ritransmetime radio TV difuzive të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media, ndryshimet e tilla duhet të koordinohen me Komisionin e Pavarur për Media.</p> <p style="text-align: center;">Neni 56 Aktivitetet radio amatore dhe shfrytëzuesit tjerë të radio stacioneve</p> <p>Procedura për dhënien e të drejtës për aktivitete radio amatore dhe çfarëdo aktiviteti tjetër për shfrytëzim të radio stacioneve, si dhe kushtet dhe procedurat për dhënie të autorizimeve për aktivitete të tilla duhet të vendosen nga Autoriteti.</p> <p style="text-align: center;">Neni 57 Pagesat për shfrytëzim të radio frekuencave</p> <p>1. Pagesat e rregullta vjetore duhet të paguhen për përdorimin e spektrit të radio-frekuencës, gjithashtu kalkulimi, si dhe shuma e pagesave, poashtu edhe</p>	<p>(channels) on the basis of criteria set out in the legal acts result in a change of the coverage territory of radio and/or television programmes broadcast and/or re-broadcast under a license issued by the IMC, such amendments shall be coordinated with IMC.</p> <p style="text-align: center;">Article 56 Activities of Radio Amateurs and Other Radio Station Users</p> <p>The procedure for granting the right to engage in radio amateur activities and any other activity of radio station users, the conditions for such activity as well as the procedure and conditions for issuing authorizations to radio amateurs and other radio station users shall be set forth by the Authority.</p> <p style="text-align: center;">Article 57 Payments for the radio frequencies use</p> <p>1. Regular annual payments shall be paid for use of the radio frequency spectrum, and the calculation and the amount of the payments, as well as the manner of</p>	<p>odnose na pokrivenost teritorije difuzivnim radio i TV signalom ili difuzivnim radio i TV reemitovanjima licenciranim od strane Nezavisne komisije za medije, takve izmene treba da budu koordinirane sa Nezavisnom komisijom za medije.</p> <p style="text-align: center;">Član 56 Amaterske radio aktivnosti i drugi korisnici radio stranica</p> <p>Postupak za dodelu prava na amaterske radio aktivnosti i bilo koju drugu aktivnost za korišćenje radio-stanica i uslovi i postupci za dodelu odobrenja za takve aktivnosti treba da budu utvrđeni od strane Autoriteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 57 Naknada za korišćenje radio-frekvencija</p> <p>1. Redovne godišnje isplate se obavljaju za upotrebu radio-frekvencijskog spektra, kao i obračuna i iznosa plaćanja, kao i način plaćanja treba biti odobren</p>
---	---	--



<p>mënyra e pagesës duhet të miratohet nga Autoriteti në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.6 të nenit 54 të këtij Ligji.</p> <p>2. Pagesat e aprovuara sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të sigurojnë një përdorim optimal të spektrit të radio-frekuencës në pajtueshmëri me parimet e përmendura në nenin 3 të këtij Ligji.</p> <p>3. Llogaritja, si dhe shuma e pagesave të referuara në autorizimin për përdorim nuk duhet të zbatohet tek bandet e radio-frekuencave, të cilat sipas tabelës së shpërndarjes së frekuencës së radios janë subjekte tek procedura e ankandit publik në pajtueshmëri me nenin 51 të këtij Ligji, përmes së cilës shuma e pagesave për të drejtën për përdorim të spektrit të frekuencës duhet të përcaktohet në procedurën e ankandit publik.</p> <p style="text-align:center">KREU VIII NUMERACIONI, EMRAT DHE ADRESAT</p> <p style="text-align:center">Neni 58 Plani i numeracionit</p> <p>1. Plani i Numeracionit definon</p>	<p>payment shall approved by the Authority in line with the provisions of Paragraph 2.6 of the Article 54 of this Law.</p> <p>2. The payments approved according to the Paragraph 1 of this Article should ensure the optimal use of the radio frequency spectrum in accordance with the principles referred to in Article 3 of this Law</p> <p>3.The calculation and the amount of the payments referred to authorization to use shall not apply to radio frequency bands, which are, according to the Radio Frequency Allocation Table, subject to a public auction procedure in accordance with Article 51 of this Law whereby the amount of the payments for the right to use the frequency spectrum shall be established in the public auction procedure.</p> <p style="text-align:center">CHAPTER VIII NUMBERING, NAMES AND ADDRESSES</p> <p style="text-align:center">Article 58 Numbering Plan</p> <p>1. Numbering plan defines the structure,</p>	<p>od strane Vlasti u skladu sa odredbama Stava 2.6 člana 54.</p> <p>2. Isplate odobrene u skladu sa Stavom 1 ovog člana treba da obezbede optimalno korišćenje radio-frekvencijskog spektra u skladu sa principima iz člana 3. ovog zakona.</p> <p>3. Obračun i iznos isplata koji se odnosi na ovlašćenje za korišćenje ne treba da se primenjuje radio frekvencijskim opsezima, koji su, u skladu sa Tabelom za sakupljanje radio frekvencija, predmet javne aukcije u skladu sa članom 51 ovog Zakona kojim se iznos isplate za pravo na korišćenje spektra frekvencije utvrđuje u postupku javnog nadmetanja.</p> <p style="text-align:center">POGLAVLJE VIII NUMERACIJA, IMENA I ADRESE</p> <p style="text-align:center">Član 58 Plan numeracije</p> <p>1. Planom numeracije se utvrđuje</p>
--	---	--



<p>strukturën, gjatësinë dhe dhënien e numrave për qasje në rrjetat dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.</p> <p>2. Autoriteti duhet ta administrojë planin e numeracionit që të:</p> <p>2.1 sigurojë strukturim efikas dhe shfrytëzim të numrave dhe serive të numrave;</p> <p>2.2 kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij Ligji;</p> <p>2.3 sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jodiskriminuese.</p> <p>3. Autoriteti ruan të gjitha të dhënat, që lidhen me administrimin e planit të numeracionit.</p> <p>4. Autoriteti publikon caktimin e numrave dhe të serive numerike, si dhe përdoruesit e tyre në faqen e vet të internetit.</p>	<p>length and allocation of the numbers for access to the public communications networks and services.</p> <p>2. Authority shall administrate the Numbering Plan in order to:</p> <p>2.1 ensure efficient structuring and use of numbers and series of numbers;</p> <p>2.2 satisfy the reasonable needs of operators and providers of public electronic communications service for the allocation of the numbers under this Law;</p> <p>2.3 ensure that the allocation and use of numbers is fair, transparent and non-discriminatory.</p> <p>3. Authority shall keep all data related to administration of the Numbering Plan.</p> <p>4. Authority shall publish on its website the allocated numbers and number ranges, as well as their users.</p>	<p>struktura, dužina i dodela brojeva za pristup elektronskim komunikacionim mrežama i uslugama.</p> <p>2. Autoritet treba da upravlja Planom numeracije u cilju:</p> <p>2.1 obezbeđivanja efikasnog strukturiranja i korišćenja brojeva i nizova brojeva;</p> <p>2.2 zadovoljenja razumnih potreba operatora i pružalaca javnih elektronskih komunikacionih usluga za dodelu brojeva u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>2.3 obezbeđivanja dodeljivanja i korišćenja brojeva na pravedan, transparentan i nediskriminatorски način.</p> <p>3. Autoritet čuva sve podatke povezane sa upravljanjem Planom numeracije.</p> <p>4. Autoritet na svom veb-sajtu objavljuje podatke o dodeljenim brojevima i nizovima brojeva i njihovim korisnicima.</p>
---	---	---



<p style="text-align: center;">Neni 59 Përdorimi i numrave, i emrave dhe i adresave</p> <p>1. Numrat dhe seritë numerike nga plani i numeracionit mund të përdoren vetëm në bazë të vendimit të Autoritetit.</p> <p>2. Autoriteti harton rregulla edhe për caktimin dhe përdorimin e emrave dhe të adresave, duke synuar sigurimin e transparencës, ndershmërisë dhe të mosdiskriminimit të përdoruesve të tyre.</p>	<p style="text-align: center;">Article 59 Use of Numbers, names and addresses</p> <p>1. The numbers and series of numbers of the Numbering Plan may be used only pursuant to Authority decision.</p> <p>2. Authority prepares rules also for appointment and usage of names and addresses, aiming at ensuring transparency, fairness and non-discrimination for their users.</p>	<p style="text-align: center;">Član 59 Korišćenje brojeva, imena i adresa</p> <p>1. Brojevi i nizovi brojeva iz Plana numeracije mogu se koristiti samo na osnovu odluke Autoriteta.</p> <p>2. Autoritet izrađuje propise i za dodelu i korišćenje imena i adresa, sa ciljem da se obezbedi transparentnost, pravičnost i nediskriminacija njihovih korisnika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 60 Zbatimi</p> <p>1. Ofruesit e shërbimeve dhe/ose të rrjetave publike të komunikimeve elektronike duhet të sigurojnë, me shpenzime të veta dhe në pajtim me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti që parapaguesit mund t'i bartin numrat e vet në rast se ka ndërrim të ofruesit të shërbimeve, ndryshim të vendit të shërbimit të ofruar apo mënyrës së ofrimit të shërbimit.</p> <p>2. Kërkesa që të gjithë shfrytëzuesit e</p>	<p style="text-align: center;">Article 60 Implementation</p> <p>1. Providers of public communications networks and/or publicly available electronic communications services shall ensure, on their own costs and in accordance with the procedure and conditions set forth by the Authority, that subscribers can port their numbers where there is a change of telephone service provider or the location of service provision or the way of provision of services.</p> <p>2. The requirement that all subscribers</p>	<p style="text-align: center;">Član 60 Primena</p> <p>1. Pružaoci javnih elektronskih komunikacionih usluga i/ili mreža treba da obezbede, o svom trošku i u skladu sa postupcima i uslovima utvrđenim od strane Autoriteta, da pretplatnici mogu da prenesu svoje brojeve u slučaju da dođe do promene pružaoca usluga, promene mesta pružene usluge ili načina pružanja usluge.</p> <p>2. Zahtev da svi korisnici brojeva iz</p>



<p>numrave nga plani numerik nacional për të mbajtur numrat e tyre në mënyrë të pavarur nga ndërmarrësi që ofron shërbime duhet të vlejë:</p> <p>2.1 në rast të numrave gjeografik, në lokacion të caktuar; dhe</p> <p>2.2 në rastin e numrave jo gjeografik, në çfarëdo lokacioni.</p> <p>Ky paragraf nuk vlen për bartjen e numrave ndërmjet rrjetave të shërbimeve fikse dhe rrjetave mobile.</p> <p>3. Autoriteti duhet të sigurojë që çmimorja në mes të operatorëve dhe/ose ofruesve të shërbimeve që ka të bëjë me bartshmërinë e numrave është e bazuar në kosto. Për këtë qëllim, Autoriteti e ka të drejtën t'i aplikojë rregullat nga neni 40 i këtij Ligji tek të gjithë ndërmarrësit që iu referohet ky nen. Tarifat që iu imponohen parapaguesve për të gëzuar këtë të drejtë në rast se lejohen nga Autoriteti dhe në pajtim me kushtet e vendosura nga ai nuk duhet të kenë efekt dekurajues për ta shfrytëzuar këtë të drejtë. Për këtë qëllim, Autoriteti mund të caktojë çmimin tavan.</p>	<p>with numbers from the national numbering plan, who so request can retain their number(s) independently of the undertaking providing the service shall apply:</p> <p>2.1 in the case of geographic numbers, at a specific location; and</p> <p>2.2 in the case of non-geographic numbers, at any location.</p> <p>This Paragraph does not apply to the porting of numbers between networks providing services at a fixed location and mobile networks.</p> <p>3. Authority shall ensure that pricing between operators and/or service providers related to the provision of number portability is cost-oriented. For this purpose, the Authority shall have the right to apply the rules set out in Article 40 of the Law to all undertakings bound by this Article. Tariffs imposed on subscribers for the exercise of such rights in the cases permitted by the Authority and according to the conditions set forth by it may not act as a disincentive for the use of such a possibility. For this purpose, the Authority may fix a tariff ceiling.</p>	<p>Nacionalnog plana numeracije mogu da zadrže svoje brojeve nezavisno od preduzetnika koji pruža usluge primenjivaće se:</p> <p>2.1 u slučaju geografskih brojeva, na određenoj lokaciji; i</p> <p>2.2 u slučaju negeografskih brojeva, na bilo kojoj lokaciji.</p> <p>Ovaj stav se ne primenjuje na prenos brojeva između mreža fiksnih usluga i mobilnih mreža.</p> <p>3. Autoritet treba da obezbedi da je cenovnik među operatorima i/ili pružaocima usluga koji se odnosi na prenosivost brojeva zasnovan na troškovima. Za tu svrhu, Autoritet ima pravo da primeni pravila iz člana 40. ovog zakona za sve preduzetnike na koje se odnosi taj član. Naknade koje su određene pretplatnicima da ostvare to pravo u slučaju da ih Autoritet odobri i u skladu sa uslovima koje on utvrdi ne smeju da imaju destimulativno dejstvo za korišćenje tog prava. Za tu svrhu, Autoritet može da odredi maksimalnu cenu.</p>
---	--	---



Neni 61 Numrat jogjeografik	Article 61 Non-geographic numbers	Član 61 Negeografski brojevi
<p>1. Ndërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar që, kur është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht, t'u sigurojnë përdoruesve jashtë territorit të Republikës së Kosovës, mundësinë të bëjnë thirrje drejt numrave jogjeografikë të caktuar në Republikën e Kosovës, sipas planit kombëtar të numeracionit.</p> <p>2. Ndërmarrësit e rrjeteve publike telefonike, ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun nuk janë të detyruar të plotësojnë detyrimin e paragrafit 1 të këtij neni, në rastet kur pala e thirrur ka vendosur, për arsye biznesi, të kufizojë thirrjet e gjeneruara nga zona të veçanta.</p> <p>3. Ndërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të rrjeteve të komunikimeve publike duhet të lejojnë përdorimin e shërbimit publik telefonik nomadik nga përdoruesit e tyre.</p>	<p>1. Undertakings of public telephone networks or publicly available telephone services shall be obliged, where technically and economically feasible, to provide a possibility for the users from countries outside of the Republic of Kosovo to be able to call non-geographic numbers defined in the Republic of Kosovo according to National Numbering Plan.</p> <p>2. Undertakings of public telephone networks or publicly available telephone services shall not be obliged to comply with the obligation from paragraph 1 of this Article, where a called subscriber has chosen, for commercial reasons, to limit the calls originating from specific areas.</p> <p>3. Undertakings of electronic communication networks and public communications networks shall allow the use of nomadic public telephony service for their users.</p>	<p>1. Preduzetnici javnih telefonskih mreža ili javnih telefonskih usluga obavezni su da, kada je to tehnički moguće i ekonomski opravdano, obezbede korisnicima van teritorije Republike Kosovo mogućnost da pozivaju negeografske brojeve utvrđene Nacionalnim planom numeracije u Republici Kosovo.</p> <p>2. Preduzetnici javnih telefonskih mreža i telefonskih usluga dostupnih javnosti nisu u obavezi da ispune obaveze iz stava 1. ovog člana, u slučajevima kada je pozvana strana odlučila da, iz poslovnih razloga, ograniči pozive upućene iz određenih područja.</p> <p>3. Preduzetnici elektronskih komunikacionih mreža i javnih komunikacionih mreža treba da omoguće korišćenje usluge javnih telefonskih govornica od strane njihovih</p>



<p style="text-align: center;">KREU IX MASAT PËR MBROJTJEN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 62 Mbrotjtja e rrjetit nga dëmtimet</p> <p>Ndërmarrësi mban dokumentacion të plotë e të saktë për rrjetin e vet. Me kërkesë zyrtare, ndërmarrësit u japin organeve përgjegjëse sipas legjislacionit për planifikimin urban dhe njëri-tjetrit të dhëna për pjesë të këtij rrjeti, për të shmangur dëmtimin e rrjetit nga punimet nëntokësore, apo ndërtime, ose nga ndikimet e mundshme elektrike, që shkakton vënia në punë e pajisjeve të tjera pranë rrjetit të komunikimeve elektronike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 63 Mbrotjtja e rrjetit nga dëmtimet e palëve të treta</p> <p>1. Për ta parandaluar dëmtimin e mundshëm të rrjetit ekzistues të</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER IX MEASURES FOR PROTECTION OF PUBLIC ELECTRONIC COMMUNICATIONS NETWORKS</p> <p style="text-align: center;">Article 62 Protection of network from damages</p> <p>Undertaking holds an accurate and full documentation for its own network. Upon official request, the undertakings give to the institutions in charge by law on the urban planning, and also to each other data for parts of this network, in order to avoid the damages in the network from the underground or construction works or from the possible electrical influences, caused by putting into action the devices near the electronic communications network.</p> <p style="text-align: center;">Article 63 Protection of the network from damages caused by third parties</p> <p>1. Individuals or private public entities, who perform construction and excavation</p>	<p>korisnika.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE IX MERE ZA ZAŠTITU JAVNIH ELEKTRONSKIH KOMUNIKACIONIH MREŽA</p> <p style="text-align: center;">Član 62 Zaštita mreže od oštećenja</p> <p>Preduzetnik vodi kompletnu i tačnu dokumentaciju o svojoj mreži. Na zvaničan zahtev, preduzetnici dostavljaju nadležnim organima u skladu sa zakonom o urbanizmu i jedan drugom podatke o delovima te mreže, kako bi se izbeglo oštećenje mreže podzemnim radovima ili radovima na izgradnji ili eventualnim električnim uticajima koje prouzrokuje puštanje u rad druge opreme u blizini elektronske komunikacione mreže.</p> <p style="text-align: center;">Član 63 Zaštita mreže od oštećenja od strane trećih lica</p> <p>1. U cilju sprečavanja oštećenja postojeće elektronske komunikacione</p>
---	--	---



<p>komunikimeve elektronike, çdo person fizik ose juridik, që kryen punime ndërtimi e gërmimi, përpara fillimit të punimeve detyrohet të njoftojë ndërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike.</p> <p>2. Në rast se punimet në rrjetin ekzistues të komunikimeve elektronike duhet të kryhen domosdoshmërisht, të gjitha shpenzimet për mbrojtjen, shmangien ose riparimin e dëmtimeve të këtyre rrjeteve barten nga subjekti që kryen punimet.</p> <p>3. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen nga gjykata.</p> <p style="text-align: center;">KREU X TË DREJTAT DHE INTERESAT E SHFRYTËZUESVE FUNDOR</p> <p style="text-align: center;">Neni 64 Obligimet që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve për shfrytëzuesit fundor</p> <p>1. Autoriteti gjatë vendimmarrjes për obligimet që mund të imponohen duke u bazuar në Nenet 33, 34, 35, 36, 37 dhe 40 të këtij Ligji, si dhe obligimet, plotësimi i të cilave është i domosdoshëm dhe kur</p>	<p>works, are required to inform public telecommunication operators prior to commencement of these works to prevent damage to the existing electronic communication network.</p> <p>2. If the works in the existing electronic communication network are indispensable all expenditures for protecting, diverting, or repairing damage to the networks will be covered by the organization performing the works.</p> <p>3. Disputes among parties shall be resolved in court.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER X END USER'S INTERESTS AND RIGHTS</p> <p style="text-align: center;">Article 64 Obligations Related to the Provision of Services to End Users</p> <p>1. The Authority, having decided that the obligations that may be imposed under Articles 33, 34, 35, 36, 37, and 40 of this Law and the obligations the fulfillment of which is mandatory, where applicable,</p>	<p>mreže, svako fizičko ili pravno lice koje izvodi radove na izgradnji i iskopavanju, dužno je da pre početka izvođenja radova obavesti preduzetnike elektronskih komunikacionih mreža.</p> <p>2. U slučaju da se radovi na postojećoj elektronskoj komunikacionoj mreži moraju nužno izvesti, sve troškove zaštite, sprečavanja ili popravke oštećenja tih mreža snosi lice koje izvodi radove.</p> <p>3. Sporove između strana rešava sud.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE X PRAVA I INTERESI KRAJNJIH KORISNIKA</p> <p style="text-align: center;">Član 64 Obaveze koje se odnose na pružanje usluga za krajnje korisnike</p> <p>1. Autoritet prilikom donošenja odluke o obavezama koje mogu biti određene na osnovu članova 33, 34, 35, 36, 37. i 40. ovog zakona i obavezama, čije je ispunjavanje neophodno i gde je to</p>
---	--	--



<p>është e aplikueshme bazuar në nenin 38 të këtij Ligji dhe të cilat nuk janë të mjaftueshme për operatorët që kanë fuqi të ndjeshme tregu në një treg relevant duhet të imponojnë obligime që janë të përshtatshme, duke u bazuar në natyrën e problemit të identifikuar, proporcional dhe të arsyetuar në bazë të objektivave që duhet arritur, përfshirë kërkesat që ndërmarrësi të mos aplikojë çmime ekcesive, pengon hyrjen në treg apo kufizon konkurrencën duke vendosur çmime grabitqare, tregojnë preferenca ndaj shfrytëzuesve specifik, apo paketojnë shërbimet në mënyrë të paarsyeshme, gjithashtu edhe obligime për të siguruar kualitet të shërbimeve të vendosura nga Autoriteti. Për t'i mbrojtur interesat e shfrytëzuesve fundorë dhe promovuar konkurrencën efektive, Autoriteti ka të drejtën të vendosë çmime tavan, ndërmarrë masa për kontrollim të tarifave individuale dhe të imponojë obligime për orientim të tarifave kah kostot apo çmimet në tregjet e krahasueshme. Kur një ndërmarrësi i imponohen obligime për orientim të tarifave kah kostot, dispozitat e paragrafit 4 të nenit 40 të këtij Ligji duhet aplikuar <i>mutatis mutandis</i>.</p>	<p>under Article 38 of this Law are not sufficient in respect of an undertaking having SMP on the relevant market, shall impose obligations that are appropriate, based on the nature of the problem identified, proportionate and justified in the light of the objectives to be achieved, including requirements that the undertaking does not charge excessive prices, inhibit market entry or restrict competition by setting predatory prices, show undue preference to specific end-users or unreasonably bundle services, also obligations to ensure the quality of service established by the Authority. In order to protect the end-user interests and promote effective competition, the Authority shall have the right to establish price caps, apply measures to control individual tariffs and impose obligations to orient tariffs towards costs or prices on comparable markets. Where an obligation is imposed on an undertaking to orient tariffs towards costs, provisions of paragraph 4 of Article 40 of this Law shall apply <i>mutatis mutandis</i>.</p>	<p>primenljivo u skladu sa članom 38. ovog zakona i koje nisu dovoljne za operatore koji imaju značajnu tržišnu snagu na relevantnom tržištu mora odrediti obaveze koje su odgovarajuće, zasnovano na prirodi identifikovanog problema, proporcionalne i opravdane na osnovu ciljeva koje treba postići, uključujući i zahteve da preduzetnik ne primenjuje ekcesivne cene, da ne sprečava ulazak na tržište ili da ne ograničava konkurenciju određivanjem enormnih cena, da ne daje prednost određenim korisnicima ili da ne pakuje usluge na neopravdan način, kao i obaveze da obezbedi kvalitet usluga utvrđenih od strane Autoriteta. U cilju zaštite interesa krajnjih potrošača i promovisanja efikasne konkurencije, Autoritet ima pravo da utvrdi maksimalne cene, da preduzme mere za kontrolu pojedinih naknada i da određuje obaveze za orijentaciju naknada prema troškovima ili cenama na uporedivim tržištima. Kada se nekom preduzetniku odrede obaveze za orijentaciju naknada prema troškovima, odredbe stava 4. člana 40. ovog zakona treba primeniti <i>mutatis mutandis</i>.</p>
--	--	--



<p>2. Autoriteti duhet të sigurojë që kur rregullimi i tarifave, apo obligimet tjera relevante i imponohen ndonjë ndërmarrësi që ky ndërmarrës t'i mirëmbajë kostot kontabël në pajtim me rregullat e vendosura nga Autoriteti. Ky ndërmarrës në afat të caktuar nga Autoriteti duhet ta përgatis sistemin kontabël të kostove, publikojë përshkrimin e tij dhe ta dorëzojë atë tek Autoriteti, në pajtim me sistemin e kostove kontabël. Sistemi i kostove kontabël duhet të jetë konform me rregullat e kostove kontabël të vendosura nga Autoriteti. Autoriteti e ka të drejtën që të vendosë sistemin e kostove kontabël, formatin dhe metodologjinë kontabël që do të përdoret nga ndërmarrësit ose nga ndërmarrësi i veçantë që ka fuqi të ndjeshme tregu në ndonjë treg relevant. Autoriteti duhet të publikojë sistemin kontabël në ueb faqen e vet. Pajtueshmëria e kostove kontabël me rregullat e kostove kontabël dhe aktet tjera juridike dhe me sistemet e kostove kontabël dhe/ose metodologjitë kontabël dhe/ose formatet e përgatitura nga ndërmarrësi dhe/ose të vendosura nga</p>	<p>2. The Authority shall ensure that, where tariff regulation or other relevant obligations are imposed on an undertaking, the undertaking keeps its cost accounts in accordance with the rules established by the Authority. Such an undertaking shall within the time limit established by the Authority prepare a cost accounting system, publish its description and submit it to the Authority, and comply with the cost accounting system. The cost accounting system must be in conformity with the cost accounting rules established by the Authority. The Authority shall have the right to establish a cost accounting system and the format and accounting methodology to be used by undertakings or a specific undertaking having SMP on the relevant market. The Authority shall publish the accounting system on its Web page. Compliance of an undertaking's cost accounting with the cost accounting rules and other legal acts as well as with the cost accounting system and/or accounting methodology and/or format prepared by the undertaking and/or established by the Authority shall be</p>	<p>2. Autoritet treba da obezbedi da kada regulisanje tarifa ili druge relevantne obaveze budu određene nekom preduzetniku, taj preduzetnik vodi računovodstvenu evidenciju troškova u skladu sa pravilima utvrđenim od strane Autoriteta. Taj preduzetnik u roku koji odredi Autoritet treba da pripremi sistem obračuna troškova, da objavi njegov opis i dostavi ga Autoritetu u skladu sa sistemom za obračun troškova. Sistem za obračun troškova mora biti u skladu sa pravilima troškovnog računovodstva utvrđenim od strane Autoriteta. Autoritet ima pravo da uspostavi sistem obračuna troškova, format i računovodstvenu metodologiju koja će biti korišćena od strane preduzetnika ili individualnog preduzetnika koji ima značajnu tržišnu snagu na nekom relevantnom tržištu. Autoritet treba da objavi računovodstveni sistem na svom veb-sajtu. Usaglašenost računovodstvenih pravila sa pravilima troškovnog računovodstva i/ili računovodstvenim metodologijama i/ili formatima pripremljenim od strane preduzetnika i/ili uspostavljenim od strane Autoriteta</p>
--	--	--



<p>Autoriteti duhet të verifikohen nga një auditim. Mendimi i auditorit duhet të publikohet çdo vit në pajtim me rregullat e vendosura nga Autoriteti.</p> <p style="text-align: center;">Neni 65 Transparenca dhe publikimi i informacionit</p> <p>1. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të publikojnë, të bëjnë transparente, të krahasojnë dhe në mënyrë adekuate dhe të përditësuar të informojnë për tarifatat dhe çmimet e aplikuara, për të gjitha pagesat deri në përfundim të kontratës dhe për përfundimin e kontratës dhe për termat dhe kushtet standarde që kanë të bëjnë me qasje dhe shfrytëzim të shërbimeve që ofrohen nga ata për shfrytëzuesit fundorë dhe konsumatorët në pajtim me rregullat për publikim të informatave dhe dërgim te Autoriteti, përfshirë këtu qëllimin dhe përmbajtjen e informatave, kufizimet kohore, formën dhe metodën e publikimit dhe/ose dërgimit dhe rregullat për kontroll kualiteti.</p> <p>2. Autoriteti duhet të inkurajojë ofrimin e</p>	<p>verified by an audit. The audit opinion shall be published annually in accordance with the rules established by the Authority.</p> <p style="text-align: center;">Article 65 Transparency and Publication of Information</p> <p>1. Providers of publicly available electronic communications services shall make publicly available transparent, comparable, adequate and up-to-date information on applicable prices and tariffs, on any charges due on termination of a contract and on standard terms and conditions in respect of access to, and use of, services provided by them to end-users and consumers in accordance with the rules for the publication of information and its submission the Authority, including the scope and content of information, the time limit, form and method of its publication and/or submission, and quality assessment rules.</p> <p>2. Authority shall encourage the</p>	<p>mora biti proverena revizijom. Mišljenje revizora treba da bude objavljeno svake godine u skladu sa pravilima utvrđenim od strane Autoriteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 65 Transparentnost i objavljivanje informacija</p> <p>1. Pružaoci javnih elektronskih komunikacionih usluga treba da objavljuju, učine transparentnim, upoređuju i adekvatno i ažurirano obaveštavaju o naknadama i cenama primenjenim za sva plaćanja do raskidanja ugovora i o raskidanju ugovora i o standardnim pravilima i uslovima koji se odnose na pristup i korišćenje usluga koje oni pružaju krajnjim korisnicima i potrošačima u skladu sa propisima za objavljivanje informacija i dostavljanje Autoritetu, uključujući i namenu i sadržaj informacija, rokove, formu i metodu objavljivanja i/ili dostavljanja i pravila za kontrolu kvaliteta.</p> <p>2. Autoritet treba da podstiče pružanje</p>
---	--	---



<p>informacionit krahasues që t'u mundësojë përdoruesve fundorë dhe konsumatorëve ta bëjnë një vlerësim të pavarur të kostos së pakove alternative të shërbimeve, si për shembull duke përdorur udhëzues interaktivë, ose teknika të ngjashme. Kur një mjet i tillë nuk ofrohet në treg pa pagesë, apo me një çmim të arsyeshëm, Autoriteti mund të vendosë për të krijuar udhëzues, apo mundësi teknike të tilla nëpërmjet prokurimit apo duke përdorur resurse të veta të brendshme. Palët e treta duhet të kenë të drejtën që të përdorin, pa pagesë, informacionin e publikuar nëpërmjet udhëzuesve interaktivë, apo teknikave të ngjashme nga ndërmarrësit që ofrojnë shërbime dhe/ose rrjeta të komunikimeve elektronike publike me qëllim të shitjes ose bërjes së mundshme të këtyre rrjetave dhe/ose shërbimeve dhe komunikimeve elektronike.</p> <p>3. Ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave të komunikimeve elektronike publike, përveç tjerash duhet të:</p> <p>3.1 iu ofrojnë informata parapaguesve për tarifën e aplikuar për çfarëdo numri dhe shërbimi që ka</p>	<p>provision of comparable information to enable end-users and consumers to make an independent evaluation of the cost of alternative usage patterns, for instance by means of interactive guides or similar techniques. Where such facilities are not available on the market free of charge or at a reasonable price, Authority may decide upon development of such guide or techniques available itself or through third party procurement. Third parties shall have a right to use, free of charge, the information published by undertakings providing electronic communications networks and/or publicly available electronic communications services for the purposes of selling or making available, such interactive guides or similar techniques.</p> <p>3. Providers of publicly available electronic communications networks and (or) services shall inter alia:</p> <p>3.1 provide applicable tariff information to subscribers regarding any number or service subject to</p>	<p>uporedne informacije kako bi omogućio krajnjim korisnicima i potrošačima da izvrše nezavisnu procenu troškova alternativnih paketa usluga, kao na primer korišćenjem interaktivnih vodiča ili slične tehnike. Kada takvo sredstvo nije dostupno na tržištu bez naknade ili po razumnoj ceni, Autoritet može da odluči da sačini vodič ili takve tehničke mogućnosti putem nabavke ili korišćenjem svojih internih resursa. Treća lica bi trebalo da imaju pravo da koriste, bez naknade, informacije objavljene putem interaktivnih vodiča ili sličnih tehnika od strane preduzetnika koji pružaju javne elektronske komunikacione usluge i/ili mreže za potrebe prodaje ili stavljanja na raspolaganje tih mreža i/ili usluga i elektronskih komunikacija.</p> <p>3. Pružaoци javnih elektronskih komunikacionih usluga i mreža bi trebalo, između ostalog, da:</p> <p>3.1 pruže pretplatnicima informacije o primenjenim tarifama za bilo koji broj i uslugu koja se odnosi na</p>
--	---	---



<p>të bëjë me kushte specifike të çmimeve; kur kemi të bëjmë me kategori individuale shërbimesh Autoriteti mund të kërkojë që informatat e tilla të jepen para se lidhja të vendoset;</p> <p>3.2 informojë parapaguesit për çfarëdo ndryshimesh për qasje në shërbime emergjente dhe për vendndodhjen e thirrësit për shërbimet për të cilat janë parapaguar;</p> <p>3.3 informojë parapaguesit për çfarëdo ndryshimi të kushteve që limitojnë qasjen dhe/ose shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikacioneve, kur kushtëzimet e tilla lejohen me legjislacion nacional;</p> <p>3.4 ofrojë informata për çfarëdo procedure që ndërmerret nga ofruesi i shërbimeve për matje dhe menaxhim të trafikut për të shmangur ngarkesat, apo mbingarkesat e linkut dhe se si këto procedura mund të ndikojnë në kualitetin e shërbimit;</p> <p>3.5 informojë parapaguesit për të</p>	<p>particular pricing conditions; with respect to individual categories of services, Authority may require such information to be provided immediately prior to connecting the call;</p> <p>3.2 inform subscribers of any change to access to emergency services or caller location information in the service to which they have subscribed;</p> <p>3.3 inform subscribers of any change to conditions limiting access to and/or use of services and applications, where such conditions are permitted under national law;</p> <p>3.4 provide information on any procedures put in place by the provider to measure and shape traffic so as to avoid filling or overfilling a network link, and on how those procedures could impact on service quality;</p> <p>3.5 inform subscribers of their right</p>	<p>specifichne uslove cena; kada se radi o pojedinoj kategoriji usluga, Autoritet može da zahteva da takve informacije budu date pre nego što se veza uspostavi;</p> <p>3.2 obaveštavaju pretplatnike o svim promenama pristupa hitnim službama i lokacije pozivaoca za usluge za koje su se pretplatili;</p> <p>3.3 obaveštavaju pretplatnike o svakoj promeni uslova koji ograničavaju pristup i/ili korišćenje usluga i aplikacija, kada su takva uslovljavanja dopuštena nacionalnim zakonodavstvom;</p> <p>3.4 pružaju informacije o svim postupcima sprovedenim od strane pružaoca usluga za merenje i upravljanje saobraćajem u cilju izbegavanja opterećenja ili preopterećenja linka i kako ti postupci mogu da utiču na kvalitet usluge;</p> <p>3.5 obaveštavaju pretplatnike o</p>
---	--	---



<p>drejtat për të vendosur për përfshirje, ose mospërfshirje të të dhënave personale në informatorët telefonikë dhe për llojin e të dhënave për të cilat bëhet fjalë konform këtij Ligji dhe legjislacionit të BE-së për mbrojtje të të dhënave dhe privatësi në komunikime elektronike</p> <p>3.6 rregullisht informojë parapaguesit me nevoja të veçanta për detalet e produkteve të dizajnuara për ta.</p> <p>4. Autoriteti mund të kërkojë nga ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave të komunikimeve elektronike publike ta informojnë publikun me informata që kanë rëndësi publike, pa pagesë, për parapaguesit ekzistues apo ata të rinj në mënyrë të njëjtë sikurse parapaguesit e rregullt. Në këto raste informatat e tilla ofrohen nga autoritetet relevante publike në format të standardizuar dhe përveç tjerash duhet të përmbajnë këto çështje:</p> <p>4.1 përdorimet më të shpeshta të shërbimeve të komunikimeve</p>	<p>to determine whether or not to include their personal data in a directory, and of the types of data concerned, in accordance with this Law , and EU legislation for data protection and privacy on electronic communications; and</p> <p>3.6 regularly inform disabled subscribers of details of products and services designed for them.</p> <p>4. Authority may require that publicly available electronic communications networks and (or) services distribute public interest information free of charge to existing and new subscribers, where appropriate, by the same means as those ordinarily used by them in their communications with subscribers. In such a case, that information shall be provided by the relevant public authorities in a standardized format and shall, inter alia, cover the following topics:</p> <p>4.1 the most common uses of electronic communications services</p>	<p>pravima da odluče o uključivanju ili neuključivanju ličnih podataka u telefonske imenike i o vrsti podataka o kojima se radi u skladu sa ovim zakonom i zakonodavstvom EU za zaštitu podataka i privatnosti u elektronskim komunikacijama.</p> <p>3.6 redovno obaveštava pretplatnike sa posebnim potrebama o detaljima proizvoda dizajniranih za njih.</p> <p>4. Autoritet može da zahteva od pružaoca javnih elektronskih komunikacionih usluga i mreža da, bez naknade, informišu javnost informacijama koje su od javnog značaja o postojećim pretplatnicima i onim novim na isti način kao i o redovnim pretplatnicima. U tim slučajevima, takve informacije se dostavljaju od strane nadležnih javnih autoriteta u standardizovanom formatu i, između ostalog, treba da sadrže sledeće:</p> <p>4.1 najčešće korišćenje elektronskih komunikacionih usluga za obavljanje</p>
--	--	--



<p>elektronike për të kryer aktivitete të paligjshme apo për të shpërndarë përmbajtje të dëmshme, posaçërisht kur kemi të bëjmë me të drejtat dhe liritë e të tjerëve, përfshirë të drejtën e autorit dhe të drejtat e ngjashme, si dhe konsekuencat legale për to; dhe</p> <p>4.2 mënyrat për mbrojtje nga rreziqet që kanë të bëjnë me siguri personale, privatësi dhe të dhëna personale kur shfrytëzohen shërbimet e komunikimeve elektronike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 66 Të drejtat dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shfrytëzuesve fundorë</p> <p>1. Kur shfrytëzuesit fundor i ofrohet pajisja fundore falas, apo me pagesë, e cila është më e ultë sesa çmimi blerës, ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të vendosë në kontratë për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike diferencën e çmimit të kësaj pajisjeje me dhe pa çmim të shërbimit, si dhe periudhën kohore dhe mënyrën në të cilën do të bëhet</p>	<p>to engage in unlawful activities or to disseminate harmful content, particularly where it may prejudice respect for the rights and freedoms of others, including infringements of copyright and related rights, and their legal consequences; and</p> <p>4.2 the means of protection against risks to personal security, privacy and personal data when using electronic communications services.</p> <p style="text-align: center;">Article 66 Rights and Obligations of the Electronic Communications Service Providers and End Users</p> <p>1. When providing a user with terminal equipment free of charge or when offering the terminal equipment at a lower price than its cost price, the provider of publicly available electronic communications services must indicate in the contract on the provision of electronic communications services the difference in its selling price with and without a service provision contract as</p>	<p>nelegalnih aktivnosti ili za raspodelu štetnih sadržaja, naročito kada se radi o pravima i slobodama drugih osoba, uključujući i autorsko i srodna prava i zakonske posledice za njih; i</p> <p>4.2 načine zaštite od rizika vezanih za ličnu sigurnost, privatnost i lične podatke kada se koriste elektronske komunikacione usluge.</p> <p style="text-align: center;">Član 66 Prava i obaveze pružalaca elektronskih komunikacionih usluga i krajnjih korisnika</p> <p>1. Kada se krajnjem korisniku ponudi terminalni uređaj besplatno ili uz naknadu koja je niža od nabavne cene, pružalac javnih elektronskih komunikacionih usluga u ugovoru o pružanju elektronskih komunikacionih usluga treba da navede razliku u ceni tog uređaja sa i bez cene usluge, kao i vremenski period i način na koji će biti izvršena kompenzacija te razlike.</p>
---	---	---



<p>kompensimi i kësaj difference.</p> <p>2. Ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të ekzaminojë të gjitha aplikacionet, propozimet dhe ankesat që i pranon dhe kanë të bëjnë me shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara apo që pretendohet të ofrohen nga ai dhe të përgjigjet në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit.</p> <p>3. Ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të informojë pa pagesë parapaguesit për shërbimet e ofruara dhe për tarifën dhe çmimet, nëse këtë e kërkon parapaguesi.</p> <p>4. Ofruesit e shërbimeve telefonike publike që ofrojnë qasje në rrjetin telefonik publik duhet të ofrojnë edhe shërbime ndihmëse asistuese për shfrytëzuesit fundorë. Autoriteti duhet të aprovojë rregulloren për ofrimin e shërbimeve të asistencës nga ofruesit e shërbimeve.</p> <p>5. Ndërmarrësve që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike</p>	<p>well as the period of time and manner in which this difference will be compensated.</p> <p>2. The provider of electronic communications services shall examine all of the received applications, proposals and complaints concerning electronic communications services provided or intended to be provided by it and issue a reply within 15 days from the receipt thereof.</p> <p>3. The provider of electronic communications services shall inform the subscriber free of charge about the services provided and about tariffs and prices if the subscriber so requests.</p> <p>4. Providers of publicly available telephone services providing end users with access to the public telephone network shall ensure the provision of assistance services to end users. The Authority shall establish the rules for the provision of assistance services by the service provider.</p> <p>5. Undertakings providing electronic communications networks and/or</p>	<p>2. Pružalac elektronskih komunikacionih usluga treba da razmotri sve prijave, predloge i žalbe koje primi, a koje se odnose na elektronske komunikacione usluge koje pruža ili koje namerava da pruža i da odgovori na njih u roku od 15 dana od dana prijema.</p> <p>3. Pružalac elektronskih komunikacionih usluga treba da bez naknade obavesti pretplatnike o ponudnim uslugama i tarifama i cenama ako to zahteva pretplatnik. .</p> <p>4. Pružaoci javnih telefonskih usluga koji pružaju pristup javnoj telefonskoj mreži treba da pružaju i pomoćne usluge podrške za krajnje korisnike. Autoritet treba da donese pravilnik o pružanju pomoćnih usluga podrške od strane pružalaca usluga.</p> <p>5. Preduzetnicima koji pružaju elektronske komunikacione mreže i/ili</p>
--	---	--



